

## INTERVISTË ME SALIH SPAHIUN

Prishtinë | Data: 22 tetor, 2018

Kohëzgjatja: 94 minuta

Të pranishëm:

- Salih Spahiu (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamerë)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Aurela Kadriu:** A mundeni zotëri Spahiu me e prezentu vetën edhe me na kallxu diçka për kujtimet e fëminisë? Domethanë, familjen e ju, vendin ku jeni rritë, çkado që mbani mend prej fëminisë t'juj.

**Salih Spahiu:** Po. Unë kam lind më 26 janar 1946 në Tiranë, në Shqipëri. Fëmijërinë e kam kalu një pjesë në Prizren, ndërsa pjesën tjetër në Gjakovë deri në klasën e katërt të shkollës fillore. Pastaj kemi kalu në Obiliq te motra edhe dhandrri kemi jetu aty, unë edhe nana e ndjera, për arsye të gjendjes së vështirë materiale t'cilën ishim në atë kohë pasi babai e patën dënu në vitin '45 politikisht ndërsa në vitin '46 e kanë pushkatu këtu në Prishtinë. Mu babai m'ka lanë shumë të vogël, 20 ditësh, unë ata e mbajë në mend vetem nëpërmjet fotografive.

**Aurela Kadriu:** A m'tregon, a t'kanë tregu pse keni qenë në Tiranë kur keni lind?

**Salih Spahiu:** Në Tiranë kam lind për arsyna që është dashtë, nana për arsyna shëndetësore domethanë mjekësore. Ka pasë specialist italian atje dhe për atë arsye është bo lindja ime atje në Tiranë. Atje kam qëndru vetëm pak ditë si bebe dhe pastaj kemi kalu në Prizren ku kemi jetu në Prizren.

Shkollën fillore e kam kry në ni pjesë, thashë, në Gjakovë deri në klasën e katërt ndërsa deri në klasën e tetë kam qenë në Obiliq aty edhe ku kemi jetu së bashku me dhandrrin edhe motrën. Pas shkollës fillore jam regjistru në gjimnazin "Ivo Lllolla Ribar" të quajtnun atë far kohe...

**Aurela Kadriu:** A kthehemi te fëminia e hershme. A mundesh me na tregu pse është dënu baba në 1945-tën edhe pse mandej përfundimisht është pushkatu?

**Salih Spahiu:** Baba ka qenë kryetar i parë i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare dhe në atë kohë bashkë me disa atdhetarë tjerë kanë bo përpjekje për çështjen e Kosovës dhe për këtë arsye regjimi i atëhershëm e ka dënu, politikisht domethanë. Ndoshta vlen t'përmendi se ai ka qenë edhe n'delegacionin e parë te Titoja ku kanë kërku që Kosova të ngel ose si e pavarur krejtësisht si republikë ose të bashkohet me Shqipërinë. Për këtë arsye edhe kanë lind ato problemet politike, t'cilat, për të

cilat ai ka marrë ni dënim s'pari burgim 21 vjet, pastaj e kanë shndërru, në burgim, në pushkatim dhe është pushkatu me 26, me 16 shkurt, 1946. Unë atë kohë isha femi vetëm 20 ditësh, dhe si thashë më parë e mbaj babën mend vetëm me anë të fotografisë. Ai në atë kohë ka qenë në moshën 49 vjeçare.

**Aurela Kadriu:** A ka ndonjë tregim që iu është përcjell juve për babën, prej nanës ose prej kujt do, a keni diçka që ju kanë tregu për babën?

**Salih Spahiu:** Po baba ka qenë, ka qenë së bashku me axhallarët, ka qenë tregtar në atë kohë, tregtar me zo, dhe e kanë pasë firmën "Vllazën Spahija" në Shqipërinë e Veriut, po edhe në disa qytete tjera të Shqipërisë ku kanë vepru. Edhe përveç tregtisë ata kanë dhanë ni kontribut të çmushëm edhe në zhvillimin ekonomik të atyre viseve të Malsisë, e ashtuquajtura Malsia e Gjakovës. Pastaj ka ndihmu Lëvizjen Nacional Çlirimtare, nuk ka qenë pjesëmarrës por materialisht e ka ndihmu Lëvizjen Nacional Çlirimtare. Mirëpo, ma vonë nuk është pajtu me mbetjen e Kosovës nën Serbi dhe kjo ka qenë një prej arsyeve ma të, si me thanë, ma dominante që atij ma vonë i ka kushtu edhe me jetë.

**Aurela Kadriu:** M'tregut ma herët që keni pasë katër motra edhe ju keni qenë ma i vogli. Qysh ka qenë kjo lloj jete për juve si femi?

**Salih Spahiu:** Po motrat e mia kanë qenë... motra e madhe e ka kry, e ka ndërpre shkollimin në moshën 16 vjeçare për arsye se baba në atë kohë ka qenë në burg, ndërsa motra e dytë dhe motra e tretë e kanë kry Shkollën Normale dhe kanë qenë punëtor të arsimit, punëtore te arsimit. Unë ju thashë edhe ma herët që kam jetu në Obiliq, te motra e dytë e cila ka qenë mësuese së bashku me bashkëshortin e vet, dhe aty kam kalu së bashku me nanën edhe motrën time të vogël e kam kalu fëmijërinë.

Prej fëmijërisë kisha me veçu nashta ditët e verës kur kam shku në Gjakovë te motra e madhe edhe te dhandrri i madh edhe me shokë e me mocanikat e mi kemi shku në Erenik, n'Dri për t'u la. Pastaj edhe najhere për vikend në Deçan. Këto kanë qenë ditë kshtu të fëminisë t'cilat m'kujtohen, që m'kanë lanë ni mbresë bukur të madhe për arsye se në atë kohë nuk ka pasë shumë lodra edhe gjana tjera siç ka sot, domethanë, argëtimi vetëm ka qenë ose lujtja me top ose kur ka qenë koha e mirë shkumja në Erenik, në Dri, në Deçan e tjera.

**Aurela Kadriu:** A e mbani në mend çfarë qyteti ka qenë Gjakova në fëmininë e juv? Domethanë, jemi t'u fol dikund për vitet e '50-ta a?

**Salih Spahiu:** Po.

**Aurela Kadriu:** Çfarë qyteti ka qenë?

**Salih Spahiu:** Po Gjakova ka qenë ni qytet i vogël, mirëpo me ni traditë qytetare. Ma tepër ka dominu jeta e zanatlive, nuk ka pasë domethanë industri në atë kohë. Mirëpo ka pasë ni rregull në qytet dhe ai rregull është përcjell pastaj edhe në familje ose anasjelltas prej familjës në qytet. Domethanë, ka qenë qyteti i pastërt, qytet i vogël simpatik dhe domethanë ato m'kanë lanë mbresa ma t'mëdha prej asaj periudhe. Këto kanë qenë gjanat t'cilat i kujtoj si diçka t'mirë në kuadër të qytetit të Gjakovës.

**Aurela Kadriu:** E Obiliqi? Se po ju pys për Obiliqin specifikisht se qysh thotë Obiliqi është nifar qytet që nuk mendojna shumë për to, thjeshtë janë termoelektranat aty edhe qaq. Çfarë qyteti ka qenë n'qat' kohë?

**Salih Spahiu:** Në kohën kur unë isha në Obiliq, në shkollën tetë vjeçare, si me thanë, atëherë filloi edhe ndërtimi i elektranave, Termoelektrana A. Obiliqi ka qenë ni qytezë shumë e vogël kryesisht ka dominu, si me thanë, klasa punëtore që kanë punu në termoelektrana, ndërsa jeta në përgjithësi në Obiliq nuk ka qenë shumë e avancune. Më kujtohet e kanë pasë veç ni kinema, ni sallë të kinemasë edhe shkollën fillore “Vllaznimi” aty ku e kam kry shkollën edhe disa dyqane, domethanë, ka qenë qytet shumë i vogël. Nëpër Obiliq ka kalu edhe, si me thanë, hekurudha e cila e ka lidhë Fushë Kosovën me vene tjera në veri të Kosovës. Domethanë, ka qenë ni vend tejet i lanun mas, mirëpo me zhvillimin, me fillimin e ndërtimit të termoelektranave filloi edhe jeta në Obiliq, sado pak të ndryshojë por jo në atë masë çfarë e ka merituri ose sa e meriton Obiliqi, si ni vend që është burim i energjetikës në Kosovë.

**Aurela Kadriu:** E kur edhe pse vendosët me shku në gjimnaz në Prishtinë në “Ivo Lolla”?

**Salih Spahiu:** Po une si fillorist kur e kreu tetë vjeçarën u përcaktova për gjimnaz dhe në atë kohë kam udhëtu prej Obiliqit në Prishtinë vazhdimisht me autobus, po autobusat nuk kanë qenë kaq shpesh qysh janë sot, qysh po ndodhë sot. Bile shpesh herë m'kujtohet ka ndodhë që autobusi ka ngelë në Shkabaj për arsye të borës së madhe edhe na udhëtarët kemi dalë pastaj edhe nxansat kemi dalë me e shty për me mujt me fillu përsëri me lëvizë.

Në gjimnaz kom ndejt...domethanë, gjatë kohës së gjimnazit tri vjet kam qenë, kam udhëtu vazhdimisht prej Obiliqit në Prishtinë dhe anasjalletas, m'kujtohet që bonte dimrit shumë acar autobusat qarkullonin tepër tepër rrallë. Një vjet kam nejt te motra ime e vogël, në atë kohë dhandrri ishte në specializim në Paris, kështu që atë vjet nuk kam udhëtu prej Obiliqit për në Prishtinë.

Në gjimnaz m'kujtohet mirë kriteret kanë qenë tepër të ashpra. Në klasë unë kam qenë në drejtimin e shkencave natyrore. Në klasë kemi qenë diku ka nize të nxënës, prej tyre pas përfundimit të gjimnazit shumica kanë shku në studime dhe me sukses i kanë kry studimet, janë bo mjek, inxhinierë, stomatologë e tjera. Më kujtohet mirë që kujdestari i klasës, i ndjeri profesori Hamdi Spahiu bënte ni luftë me e qujt në thojza të pakompromis me disa nxënës shokë t'mi t'cilët fillun në atë kohë me pi duhanin, dhe ai i ndjekte në çdo hap shoktë për arsye se e dinte se çfarë dami mund të sjellë duhani në shëndetin e tyre si t'ri, por edhe ma vonë si t'pjekur.

Gjatë gjimnazit kemi pasë aktivitete të lira të ndryshme. Më kujtohet unë jam përcaktu për klubin e foto-amaterëve dhe aty kam punu ni kohë bukur të gjatë në kohë t'libë prej nga ka lind edhe dashuria për fotografi e për, në përgjithësi për art edhe për gjana që kanë të bëjnë me ni estetikë e me atë që ne e qujm art në përgjithësi, në tërësi.

**Aurela Kadriu:** A keni pasë kamera?

**Salih Spahiu:** Kamera jo. Kemi pasë disa fotoaparate të, të... si me thanë të, të asaj kohe që kanë qenë me performanca shumë të vogla. M'kujtohet ka qenë ai fotoaparati “Llajka” ni prodhim shumë i thjeshtë mirëpo edhe n'projektor kur i bojshim fotografitë u mbyllshin në dhoma të mbyllta pa dritare,

të errëta për me zhvillu filmin e tjera. Domethanë është punu me ni mënyrë bukur të prapambetur me thanë, mirëpo në atë kohë ato kanë ekzistuar si mundësi reale.

**Aurela Kadriu:** Dashta me iu pyet edhe prej çka po m'tregoni prej fëminisë t'juj diqysh po m'doket që shumë keni kalu kohë me nanën. A m'tregon qysh ka qenë nana juj, çfarë prapavije ka pasë?

**Salih Spahiu:** Nana ime ka qenë amvise, amvise mirëpo na ka edukuar mirë. Ka qenë ni gru shumë e urtë edhe na ka përkushtuar krejt jetën meqenëse kemi mbetë t'vegjël pa babanë ajo na ka përkushtuar, domethanë ata e kemi pasë edhe babë edhe nanë. Ajo ka qenë e pa shkollë, mirëpo neve gjithmonë na ka këshilluar që të msojmë, të shkojmë në shkollë edhe t'vazhdojmë që t'bohemi t'aftë për vetveten. Ajo ka vdekë diku në moshën 66 vjeçare dhe në atë kohë unë isha student në Sarajevë kur ndërroi jetë nana, megjithatë edhe pse ishte dimër arrita t'vijë për varrimin e saj.

**Aurela Kadriu:** Dashta me vazhdu te gjimnazi prapë, a doni me pushu?

**Salih Spahiu:** Jo, jo.

**Aurela Kadriu:** Qatëhere kur ja nisët me ardhë në gjimnaz filloni me qarkullu ma shumë në qytetin e Prishtinës, a m'tregon n'qat' kohë nashta i ki kujtimet e para kur je ardhë në Prishtinë. Çfarë qyteti ka qenë Prishtina?

**Salih Spahiu:** Po, Prishtina ka qenë qytet natyrisht shumë i vogël në atë kohë, n'atë kohë ka qenë shumë i vogël. Natyrisht është dallu prej qyteteve tjera, mirëpo megjithatë ka qenë qytet i vogël. M'kujtohet që ai ka përfunduar dikund ku janë... tash me iu ilustru juve Katedralja ku është tash, aty ka përfunduar qyteti, domethanë, ka qenë tepër i vogël po u shike që do t'zhvillonte, t'zhvillohet, domethanë, fillun, si me thanë, disa signale t'zhvillimit, të zhvillimit të qytetit, po megjithatë ka pasë pak rrugë, pak rrugë dhe pak objekte. Ma vonë dikur, siç e dini, ma vonë dikur u themelua edhe universiteti. Kur u themelua universiteti ndryshoi edhe fryma edhe krejt, në, mirëpo kjo ishte në vitet e '70-ta diku, në atë kohë unë isha student jashtë Prishtinës në Sarajevë.

**Aurela Kadriu:** E qajo lagjja ku e keni pasë shkollën, qajo lagjja te "Sami Frashëri", çfarë lagje ka qenë?

**Salih Spahiu:** Ajo... gjimnazi, gjimnazi "Sami Frashëri" tash në atë kohë është qujt "Ivo Lolla Ribar" ka qenë si me thanë në bërthamën e qytetit të vjetër të Prishtinës. Ajo pjesërisht ajo pjesë është rujt, pjesërisht është rrënu. Tani është degraduar krejtësisht dhe nuk ka një kontinuitet as historik, as arkitektonik, as urbanistik, as... kanë mbetë vetëm disa objekte si fragmente. E në atë kohë ka qenë ma e rujtun si tërësi urbane dhe arkitektonike.

**Aurela Kadriu:** A na tregon ma shumë tregime ndoshta më shumë fragmente nëse keni dalë aty e keni pasë shkollën afër në atë pjesë, naj moment, në pushim t'gjatë e t'shkurt, a ma tregon atë pjesë?

**Salih Spahiu:** Po kemi dalë në pushime, natyrisht kemi dalë në pushime po jemi sill në rrethinë të gjimnazit kryesisht për nevoja, për me ngranë, për me asi jo për diçka tjetër. Vetëm kur është organizuar ndonjë shëtitje mnyrë të, mnyrë... organizuar gara drejtoria e gjimnazit kemi shku zakonisht në Gërmia në shteti edhe atje kemi shku n'kam natyrisht në kambë. Gërmia ka qenë ni vend i adhuruar prej nesh në

atë kohë qysh është edhe tash, po mjerisht ka psu degradime me ndërime të ndryshme, me mos kontrollë sa duhet dhe ni mos menxhim adekuat sa duhet.

**Aurela Kadriu:** Gjumnazi shkencor, a ishit gjenerata e parë ju që shkonit në gjumnaz të ndamë?

**Salih Spahiu:** Jo, ka pasë edhe para nesh gjenerata që... në kohën kur une kam qenë në gjumnaz ka ekzistur drejtimi shkencor edhe drejtimi shoqror. Zakonisht n'drejtimin shkencor kanë shku ma pak nxanës, drejtimi shoqror m'kujtohet ka pasë bukur ma tepër nxansa. Mirëpo, këto dy drejtime kanë qenë edhe ma herët, domethanë, edhe përpara gjeneratës tonë.

**Aurela Kadriu:** Qysh ka qenë gjumnazi për juve, drejtimi shkencor?

**Salih Spahiu:** Po drejtimi shkencor ju tregova ka qenë mjaft kriteri i ashpër. Shumë landë kemi pasë në gjuhën serbo-kroate në atë kohë për shkak t'rrethanave t'cilat kanë ekzistur në Kosovë, mirëpo kriteri edhe profesorat kanë qenë mjaft të përkushtun për punë. Kjo tregon edhe rezultatin tonë ma vonë si maturanta edhe si nxanës e studentë krejt kohën, periudhës si gjumnazista, po edhe në maturë ku shumica e nxanësve kanë dhanë sukses të shkëlqyshëm edhe kanë pastaj kanë studiu, edhe siç iu thashë janë bo mjekë, stomatologë, inxhinierë dhe profilet tjera t'cilat, të cilat janë mjaft vështirë si, si studime, si fakultete.

**Aurela Kadriu:** Qysh ndodh që ju vendosni me studiu arkitekturën?

**Salih Spahiu:** Une për studimet e arkitekturës kam vendosë diku në vitin e tretë të gjumnazit. E kam pasë ni profesor që ma jepke landën gjeometria deskriptive, ai m'ka inkuraju, m'ka inkuraju mjaft për me studiu arkitekturën edhe qysh atëherë fillova të interesohem për arkitekturë. M'kujtohet fillova të shfletoj edhe të shoh kush janë arkitektët, cilat janë arkitektët, veprat e tyre e tjera, e tjera. Njo prej tyre që m'ka lanë mbresa ishte Le Corbusier, ai është arkitekt me prejardhje nga Zvicra, por ka jetu edhe ka punu në Francë, në Paris. Edhe mjerisht e ka përfundu jetën, është mbyt dikun në detin Mesdhe nëse s'gaboj. Mirëpo, veprat e tij kanë qenë ni inspirim, veprat e tij dhe t'kolasëve tjerë të arkitekturës kanë qenë ni inspirim për mu. Por, ajo që ka qenë dominante ka qenë inspirimi nji dhe e dyta inkurajimi i profesorit të gjeometrisë deskriptive i cili ishte me kombësi serbe emrin nuk ia mbaj në mend tash, po gjithnjë m'thonte, "Ti duhet të shkosh në arkitekturë", kështu që kam shku në studime të arkitekturës në Sarajevë.

**Aurela Kadriu:** E pse e vendosët... qysh erdh puna me shku në Sarajevë?

**Salih Spahiu:** Po kisha, i kisha disa kolegë atje dhe i pata kolegë, po mendoj ma vonë u bona koleg me ta, i pata porositi që t'më informojnë si qendron puna. Në Sarajevë ka pasë shumë student nga Kosova, jo vetëm në arkitekturë por në Universitetin e Sarajevës në përgjithësi prandaj edhe vendosa t'shkoj atje. Unë mendoj se Fakulteti i Arkitekturës në Sarajevë atje që është qujt Fakulteti Urbanistiko Arikektonik ka qenë njëri prej fakulteteve ma të njohura në ish Jugosllavi ku kanë punu ekspertë edhe profesorë të njohur të arkitekturës tash nëse mund t'i përmendi edhe disa prej emrave t' tyre që kanë lanë gjurmë të madhe edhe në arkitekturën, jo vetëm të Bosnjës dhe Hercegovinës po edhe në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë. Aty është profesori (nuk e gjej emrin min 21:27), pastaj Zlatko Ugljen, pastaj Dzemal Celic, pastaj Ivan Taubman, (nuk e kuptoj min 21:36), Zivorad Jankovic, Millosh Sonborci e

shumë të tjerë të cilët vërtetë kanë qenë në nivel të lartë profesional dhe si pedagogë të jashtzakonshëm.

**Aurela Kadriu:** N’cilin vit keni shku n’studime?

**Salih Spahiu:** Në vitin ‘65-‘66.

**Aurela Kadriu:** E qysh ka qenë me shku prej një feminine n’mes Obiliqit, Gjakovës, edhe Prishtinës me shku me ni vend si Sarajeva?

**Salih Spahiu:** Po natyrisht si çdo fillim nuk ka qenë lehtë, mirëpo duhet njeriu të parapërgaditet për çdo sfidë në jetë edhe kur jam shku atje kam qenë i preokupum me studime. Nuk ka ngelë shumë kohë me mendu për gjana tjera, për arsye se fakulteti i arkitekturës ka lyp ni punë konstante, ka pasë ushtrime të përditshme dhe ligjerata t’përditshme. Mund t’ju them se ato i kam ndjek me përpikni dhe edhe ajo ka qenë një prej preokupimeve t’mia kryesore gjatë kohës së studimeve.

**Aurela Kadriu:** Çfarë qyteti ka qenë Sarajeva? A ka qenë e zhvillume?

**Salih Spahiu:** Sarajeva ka qenë n’krahësim me qytetet tona në Kosovë shumë ma e zhvillune natyrisht. Sarajeva është ni gërshetim... vet qyteti është ni gërshetim i arkitekturës orientale dhe arkitekturës evropiane. Ai gërshetim mund t’them që është mjaft i suksesshëm dhe m’u për këtë Sarajeva është një prej qytetet që vizitohet shumë nga turistët. Nëse... natyrisht nuk ka qenë qysh është sot me objekte shumë bashkëkohore e tjera e tjera, mirëpo patën fillu të ndërtohen objektet e rëndësishme të jetës edhe publike edhe banesore edhe kulturore.

Në atë kohë sa isha student u ndërtu edhe qendra sportive rekreative “Skenderija” në Sarajevë, njëri prej autorëve është kryearkitekt është profesor Zivorad Jankovic i ndjerë, i cili pastaj ka punu edhe në Prishtinë. Ka punu pallatin e “Boro Ramizit” të ashtuquajturin “Bora Ramizi” tash “Pallati i Rinisë”, pastaj në qendrën “Vojvodina” në Novi Sad e që është ni objekt i ndërtun special në kohën kur është mbajt edhe Kampionati Botëror në tenis. Pastaj në Gripe të Splitit edhe shumë objekte tjera të natyrës, si me thanë, kapitale për atë kohë edhe për këtë kohë. Profesor Jankovici ka qenë njëri prej arkitektëve ma eminent në ish-Jugosllavi dhe ka shumë objekte në Bosnje po se po, por edhe në vende tjera të ish-Jugosllavisë.

**Aurela Kadriu:** E qysh ke për juve kur e murret vesh që Pallatin e Rinisë po e ndërton profesori ju?

**Salih Spahiu:** Po n’atë kohë për Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve u shpall konkurs. Në atë konkurs kanë marrë pjesë edhe firmat tjera nëse m’kujtohet mirë nga Beogradi dhe Zagrebi, nuk e di prej Ljubljanes a ka pasë a jo, ata e fitun shpërblimin, si me thanë, çmimin e parë. Unë në atë kohë isha sa pata fillu t’punoj në Prishtinë dhe iu dërgova ni telegram urimi atyne. Ju erdh tepër mirë kur u publiku që ata janë fitues të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Ai Pallati i Rinisë dhe Sporteve siç e dini është ni kompleks mjaft i madh në përmbajtje të ndryshme. Përveç asaj që ka të bëj me jetën sportive, ka të bëj me jetën kulturore, me jetën ekonomike e tjera e tjera, domethanë është ni objekt multifunksional.

Kompleksi nuk është, siç e dini nuk është përfundu në tërësi. Mbrapa pallatit në vazhdim të sallës universale duhej të ndërtohet edhe pishina e mbyllur edhe disa terene të hapura sportive, edhe

pasarela e cila lidh platonë e Pallatit të Rinisë me lagjën Arbëria. Besoj që edhe ato do t'realizohen në ditë. Për pishinë, ju e dini se Prishtina ka mjaft nevojë për pishinë të mbyllur. Ekziston projekti i dokumentacionit teknik, projekti ekziston i finalizun dhe sigurisht Kuvendi i Komunës pret me pasë mjete për me mujt me fillu ndërtimin pishinën e mbyllur që është në kuadër të kompleksit.

**Aurela Kadriu:** Kur po thuni ka përmbajtje të ndryshme, na që jemi arkitektë nuk e kuptojmë, a po m'shpjegovon çka i bjen? Ka përmbajtje t'ndryshme, a po flet për fasadën a...

**Salih Spahiu:** Jo, po flas për funksion, për funksion. Domethanë, në kuadër të këtij kompleksi zhvillohet jeta sportive, mund të zhvillohet jeta sportive dhe zhvillohet jeta sportive. Janë dy salla, një e vogël, një sallë universale e madhe, pastaj është pjesa e Pallatit të Rinisë, pjesa e, mund të zhvillohet jeta kulturore; ekspozita të ndryshme, ligjerata të ndryshme, pastaj koncerte të ndryshme e tjera e tjera dhe pjesa ekonomike që është kjo pjesa ku gjinden lokalet për tregti. Domethanë, janë tri funksione themelore të integruene në ni tërësi dhe funksioni i katërt kishte me qenë pishina edhe ajo si funksion i sportit dhe i notit, por kish me qenë ni përmbyllje e kompleksit si ni tërësi arkitektonike dhe me përmbajtje, domethanë, multifunksionale.

**Aurela Kadriu:** E si stil? Përpos si funksion më intereson edhe si stil çka përfaqëson për juve Pallati i Rinisë sot? Si stil i arkitekturës.

**Salih Spahiu:** Po, pa dyshim Pallati i Rinisë dhe i Sporteve është ndërtu në frymën e kohës, është projektu dhe sot jep pasqyrën e asaj kohe qysh ka qenë arkitektura në përgjithësi. Trendet bashkëkohore të asaj kohe. Megjithëse, mund t'them që ai edhe sot e kësaj dite përfaqëson ni objekt dinjitoz në aspektin arkitektonik dhe vet vullumenet e tij flasin për përmbajtjen dhe funksionin i cili gjindet në kuadër të këtij objekti.

**Aurela Kadriu:** Po kthehemi prapë te studimet, se veç dashta me u ndal masi e përmenet Pallatin e Rinisë nuk mujta veç me tejkalu. Po kthehemi hala te studimet kur e diskutum se qysh ka qenë jeta studentore në Sarajevë? Po menoj gjithçka që ka përfaqësu jetën studentore. Ma herët ma përmendet edhe ni shoqatë që e keni pasë ju studentat shqiptarë atje. Qysh është manifestu, domethanë, çka mbani mend prej kësaj jete në Sarajevë?

**Salih Spahiu:** Po jeta studentore në Sarajevë ka qenë natyrisht ma e gjallë se që ka qenë, për shembull, në Prishtinë për arsye të ni traditës edhe të universitetit edhe t'jetës studentore në përgjithësi. Prej... nëse e mendojmë në aktivitete të lira atëherë kisha me përmend aktivitetet që janë zhvillu në jetën, me rastin e jetës studentore. Në Klubin "Lulzimi" që ka qenë klubi i studentëve të, të Sarajevës, të Univeritetit të Sarajevës. Në këtë grup kanë qenë studentë kryesisht nga Kosova, kryesisht shqiptarë dhe më kujtohet mirë që kemi organizu 500 vjetorin e vdekjes së Skenderbeut.

Ai ka qenë ni manifestim vërtetë në nivel mjaft të asi, mjaft të lartë dhe në të kanë marrë pjesë shoqata e studentëve "Përpkjeka" nga Beogradi dhe "Shkendija" nga Zagrebi, gjithashtu ka qenë ni delegacion nga Kosova. Përveç ktyne kanë marrë pjesë edhe shumë personalitete të njohura të jetës publike në Hercegovinë dhe qytetarë, qytetarë sidomos qytetarë shqiptar që kanë jetu dhe jetojnë në Sarajevë. Ky manifestim boni ni jehonë t'madhe në atë kohë dhe mjetet e informimit i kushtun ni vend të veçantë. Dhe kështu u afirmu, si me thanë, edhe roli, roli edhe përpkjekjet e Skenderbeut në kohën kur ai ka luftu edhe ka dhanë kontributin e vet për çështje të ndryshme. Kjo ishte.



Në kohën e studimeve përveç këtij grupit “Lulzimi”, meqenëse në Sarajevë kishte shumë banorë shqiptar, u themelu edhe klubi i shqiptarëve “Valon Curri”. Ky klub ka pasë rol që t’i bashkon shqiptarët dhe të zhvillojë një jetë kulturore. Aty vinte shtypi pastaj ishte biblioteka e klubit ku shqiptarët mundeshin me e kalu kohën e lirë. Kjo krejt ishte n’frymën e ni, si me thanë, ni avancimi të jetës së shqiptarëve në Bosnje e Hercegovinë, barazisë n’atë kohë, barazisë nacionale që udhëheqësia e Bosnjes e Hercegovinës i ka kushtu, muj me thanë, ni kujdes të veçantë barazisë nacionale në atë kohë edhe komunitetit shqiptarë në Sarajevë.

M’kujtohet që në atë kohë është nda edhe ni kohë për emisionin shqip në gjuhën shqipe në Radio Sarajevë, ai emision ka dhanë kryesisht lajme nga Kosova dhe lajme tjera që kanë të bëjnë me shqiptarët dhe emisione tjera për jetën dhe punën e shqiptarëve kudo që ndodhen.

## Pjesa e Dytë

**Aurela Kadriu:** Kur vendosët me studiu arkitekturën çka kishit vizion me bo me arkitekturë? Pse vendosët me studiu?

**Salih Spahiu:** Arkitektura përveç që është profesion është edhe ni mision, edhe ni mision tepër i rëndësishëm në jetën e njeriut. Ju sot me projektu ni objekt do të thotë edhe me caktu fatin e atyre që kanë me shfrytëzu atë objekt, t’u fillu prej spitalit ku lind fëmiju, pastaj te objekti parashkollor ku fillon parashkollimi, pastaj shkolla, pastaj universiteti, puna dhe aktivitete tjera t’jetës kulturore, argëtuese e tjera.

Domethanë, arkitektura është e lidhur, pas mjeksisë, besoj që është një prej misioneve ma t’rëndësishme edhe një prej profesioneve me t’rëndësishme në shërbim të njeriut. Kjo ka qenë një prej motiveve, njëri prej motiveve për t’cilin jam përcaktu për arkitekturë, e dyta në atë kohë në Kosovë ka pasë shumë pak arkitektë. Arkitekti i parë shqiptar, siç e dini, ka qenë profesor Bashkim Fehmiu, i ndjeri, i cili ka vdekë para nja dhjetë viteve. Ai ka qenë arkitekti i parë shqiptar, domethanë, deri n’vitin ‘58 Kosova nuk ka pasë arkitekt shqiptar.

Projektet që janë bo për Kosovë, janë bo kryesisht jashtë Kosovës. Profesor Bashkim Fehmi ka sjell ni frymë t’re pastaj, ajo është fakt që atij iu kanë bashkangjitë edhe disa kolegë të tjerë, por ishin në masë tepër tepër të vogël. Fakulteti i arkitekturës në Kosovë, gjegjësisht në Prishtinë, ka fillu punën në vitet ‘78-‘79...

**Aurela Kadriu:** Po, prej t’fundit.

**Salih Spahiu:** I fundit. Tash ka mjaft arkitektë, po situatën nuk e kemi shumë të mirë dhe aq, si me thanë, lakmuse. Por besoj se kjo është e ndërlydhur edhe me atë se si pushteti edhe ligjet ndikojnë në kahjen e zhvillimit edhe urban edhe arkitektonik, domethanë respektimi ose mos respektimi i ligjeve reflektohet edhe në hapësirë. Te na mjerisht po na reflektohet negativisht e përgjegjësi direkte për këtë kanë pushteti qendror dhe pushteti komunal-lokal.

**Aurela Kadriu:** Kur e përmend profesor Fehmiun, unë e di që keni qenë shumë i afërt me të. A m'trego kur jeni bo shokë me profesor Fehmiun?

**Salih Spahiu:** Me profesor Bashkimin jem njoftu pas diplomimit meniherë, gjatë vitit '73. Mirëpo, jom taku disa herë, disa herë me të, e në kohën e fundit pas luftës ai ka qenë i angazhun në projektin tonë, projektin për urbanizëm dhe projekte për kompleksin përkujtimor Adem Jasharit në Prekaz. Profesori në atë kohë e formoi ni ekipë të vetën me ekspertë të ndryshëm edhe mrena entit edhe jashtë entit...

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit?

**Salih Spahiu:** Menihere pas luftës, viti '99, domethanë '99-2000. Edhe punoi në hartimin e detyrës projektuse dhe planit urbanistik për rregullimin e kompleksit Adem Jashari në Prekaz. Në atë kohe kam pasë rast që shumë orë t'i kaloj së bashku me të. Kemi bisedu shumë herë për çështjet e ndryshme, profesori ka qenë ni njeri tepër i dijshtëm, ka pasë ni njohuri jashtëzakonisht të gjanë për të gjitha lamitë, jo vetëm për arkitekturën dhe urbanizëm. Ka qenë ni njeri i cili ka shëtitë nëpër botë mjaft, ka pasë takime me arkitektë eminent dhe kolasë të arkitekturës të shekullit XX: Le Corbusier, Veralto, Pier Luigi e tjerë. Dhe sigurisht edhe prej tyre kanë marrë elemente të ndryshme t'cilat ma vonë edhe i ka apliku në jetën praktike në Kosovë dhe në Prishtinë.

Ai veprimtarinë e vet kryesisht e ka pasë në Prishtinë, mirëpo ka dhanë ni kontribut të çmushëm për arkitekturën dhe për urbanizëm edhe në nivel të Kosovës. M'kujtohet thanja e tij, "Jeta është hapësirë, hapësira është jetë". Janë dy elemente, domethanë jeta dhe hapësira janë dy elemente t'cilat janë të pandashme. Profesori i ka kushtu kujdes të veçantë jetës së njeriut edhe me anë të projekteve të tij, ai është mundu, edhe sidomos në laminë e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është mundu që jetën e njeriut në aspektin fiziologjik, psikologjik e tjera e tjera ta bëj sa ma të denjë edhe sa ma të mirë.

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit i përfundoni ju studimet në arkitekturë?

**Salih Spahiu:** Une i kam përfundu studimet në vitin 1973, në qershor të vitit 1973 edhe pastaj kam fillu të në byronë projektuese të Ramiz Sadikut te Kombinati Ndërtimor Industrial i ashtuquajtur Kombinati Ndërtimor Industrial Ramiz Sadiku. Aty kam punu ni kohë disa muj, pastaj me ftesën e kolegut të ndjerë Rexhep Lucit kam kalu në Entin Urbanistik të qytetit të Prishtinës.

**Aurela Kadriu:** Veç e kam një pyetje te studimet mandej dalim prap te jeta profesionale. Çka e keni pasë temën e diplomës? A keni pasë temë t'diplomës?

**Salih Spahiu:** Po, kemi pasë. Në qershor të vitit 1973 i kam kry studimet, kam diplomu me sukses të shkëlqyshëm te profesor arkitekti i ndjerë Zivorad Jankovic, temë të diplomës kam pasë po në Sarajevë. Ka qenë ni kompleks në mes të disa rrugëve, kompleks ku është dashtë të ndërtohen objekte afariste dhe ni kino sallë. Komisioni dhe profesori i kanë çmu me nivel të lartë.

Pas studimeve kam fillu të punoj në byronë projektuese të Kombinatis Ndërtimor Industrial Ramiz Sadiku ktu në Prishtinë. Natyrisht në fillim si bashkëpunëtor, projektues-bashkëpunëtor. Aty kam pasë kolegë ma të vjetër të cilët e kanë udhëheq projektin, ndërsa unë kam qenë bashkëpunëtor i tyre. Në vitin 1974, arkitekti i ndjerë Rexhep Luci më ka ftu të kaloj në Entin Urbanistik të qytetit të Prishtinës.

Unë ftesën e tij e pranova m'u dukë që është interesant të mirrem edhe me urbanizëm, kalova në Entin Urbanistik të qytetit të Prishtinës aty së bashku me të ndërjet Vikor Shiroka arkitekt dhe Esat Meka gjithashtu arkitekt si dhe me inxhinierë të tjerë, punum disa plane urbanistike për qytetin e Prishtinës.

Në vitin 1975 kam kalu në Entin për Urbanizëm dhe Projektme të Kosovës, në atë kohë ashtu është njoftë, i Kosovës, dhe aty kam punu deri në pensionim, deri në vitin 2011, domethanë shumë gjatë.

**Aurela Kadriu:** A rrijmë qatÿ ku keni qenë te Enti Urbanistik në Prishtinë, për Komunën e Prishtinës. Çfarë projekti keni bo në kuadër të qatij Enti?

**Salih Spahiu:** Po n'kuadër të Entit kem punu diçka për plotësimin e planit urbanistik të Ulpianës, pastaj këtu, bash ku jeni ju...

**Aurela Kadriu:** Te Qafa.

**Salih Spahiu:** Po te Qafa, s'besoj që është qujt atëherë Qafa mirëpo mbas rrugëve. Kit' kompleksin, domethanë, tash quhet Qafa e kemi punu urbanistikisht. Kemi punu edhe plane të tjera t'cilat janë të nivelit komunal që kanë qenë me rëndësi në atë kohë dhe kemi punu në kërkimin e lokacioneve të ndryshme për objekte të ndryshme të cilët ishin të rëndësishme për atë kohë.

Në atë kohë janë punu edhe projekti i Çarshisë, domethanë konservimi, rivitalizimi i çarshisë, aty ka punu kolegu Esat Meka, Çarshisë së Vjetër të Prishtinës. Mirëpo, mjerisht shumë projekte, shumë gjana kanë ngelë të porealizueshme për arsyna të ndryshme edhe politike, edhe ekonomike, edhe shoqërore e tjera, e tjera. Arkitektura edhe urbanizmi e lypin ni vullnet dhe ni mbështetje t'mirë politike për me mujt me ecë përpara gjërat. Te na ai vullnet nuk është tregu gjithmonë.

**Aurela Kadriu:** E kur është bo plani primar i Ulpianës që thatë e kena finalizu?

**Salih Spahiu:** Plani fillestar i Ulpianës është bo në viteve e '60-ta, mirëpo na e kena bo plotësimin me disa objekte, rreth rrugëve, kjo rruga e "Sremit" është qujt atëherë, tash m'duket quhet "Gjorgj Bush", nëse s'gaboÿ, te Fakulteti Filozofik. Aty edhe disa objekte brenda ku ka pasë mundësi hapsinore dhe vendosen edhe disa objekte. Kur jemi te Ulpiana m'duhet t'them se Ulpiana paraqet, për mu paraqet një prej lagjeve ma t'suksesshme të qytetit, Ulpiana, Dardania dhe Kodra e Diellit. Këtë e potencoj për arsye se sot po flitet shumë për norma dhe standarde evropiane, une aspak nuk pajtohna me atë, norma dhe standarde evropiane.

Na mund t'themi që në aspektin e materialeve ka shumë avancime, mirëpo në aspektin e konceptit unë iu them që lagjet e reja janë shumë ma mbrapa se sa Ulpiana dhe Kodra e Diellit e tjera. Mjafton t'i përmendi disa lagje këtu në Prishtinë t'cilat edhe ju i dini mirë, është për shembull kjo lagjja ktu te Hotel Siriusi mbrapa, aty e keni pa si qëndron puna në aspektin urbanistik. Nuk duhet njeriu t'jetë as arkitekt, as urbanist edhe ta vlerësoÿ. Pastaj Kalabria, Mati... ka disa lagje ku vërtetë në aspektin urbanistik janë dështime të mëdha. Për këto dështime natyrisht që përveç politikës përgjegjës janë edhe arkitektët t'cilët nuk e kanë ngrit zanin aq sa duhet dhe kur duhet në lidhje me situatën e cila po mbretëron në qytetin e Prishtinës po edhe në Kosovë në përgjithësi.

Në... gjatë viteve, sa kam qenë në Entin për Urbanizëm dhe Projektme që ma vonë u qujt edhe Enti për Konstatim dhe Inxhinierim, kam punu projekte të ndryshme të cilat janë të natyrës dhe destinimeve të ndryshme. Kisha me përmend objektet e Postës dhe Telekomunikacionit në qytetin e Vushtrrisë, Kaçanikut, Vitisë edhe Dragashit. Pastaj objektin e Kosovafilmit për t'cilin kam marrë edhe çmimin e së parit të Shoqatës të Artistëve Aplikativ të Kosovës e ma vonë e kam marrë çmimin e "Borbës" për arkitekturë për Kosovë kur është realizu objekti natyrisht edhe kam hi në konkurrencë me objekte tjera në nivel federative në ish Jugosllavi. Ky çmim ka qenë në vitin 1988. Për të njejtin objekt ma vonë nga BVI-ja për kulturë e asaj kohe e Kosovës e kam marrë ni çmim për krijimtarinë, kulturë e tjera, e tjera.

Mund t'them se objekti i Kosovafilmit në atë kohë është projektu duke iu falenderu, të ndjerit, shkrimtarit Azem Shkreli i cili ka qenë drejtor i Kosovafilmit dhe drejtorit të Entit të Inxhinierëve, Vehbi Oranës të ndjerë, nga të dy kam pasë gjatë gjithë punës kam pasë ni mbështetje të jashtëzakonshme. Objekti ka specifikat e veta, mirëpo sot është vendos siç e dini Komanda e KFOR-it për Kosovë në objektin e Kosovafilmit.

**Aurela Kadriu:** Ka me u kthy prapë te Kosovafilmi edhe po kom qef mandej me fol për qendrën tregtare. Veç dashta me ju pytë për Dardaninë, Kodrën e Diellit edhe për Ulpianën. Për Ulpianën, Ulpiana është e hershme në të '60-tat po Dardania edhe Kodra e Diellit janë diqysh do far' lagje që edhe shënojnë, si me thanë, fillimet e banimit kolektiv në Prishtinë gatise përpos Ulpianës. A keni qenë pjesë e planifikimit të këtyne lagjeve të grupit punus?

**Salih Spahiu:** Jo. Nuk kam qenë pjesë, nuk kam qenë pjesë se siç e dini Dardania është projektu në Zagreb nga autortë zagrebas, kam pasë rast të takohem me autorët e lagjës Dardanisë, është projektu në vitet e '70-ta. Mirëpo, në aspektin urbanistik une besoj që është ni lagje e suksesshme edhe kur e kqyrim në distancën kohore edhe Ulpiana, edhe Dardania, edhe Kodra e Diellit është projektu në Zagreb, urbanistikisht. Pastaj objektet i kanë projektu kryesisht janë projektu jashtë Kosovës, kryesisht janë projektu në Beograd dhe Zagreb, kryesisht, pjesa ma e madhe e objekteve. Qendra tregtare e cila ndodhet në Kodër të Diellit është projekt i imi dhe kolegut Hamdi Binakaj.

Në atë projekt na kemi qenë fitues të çmimit të parë në konkursin e thirrur, në konkurrencë kemi pasë byro të ndryshme nga Beogradi, Zagrebi dhe Shkupi dhe në bazë të çmimit të parë na është besu edhe hartimi i projektit kryesor. Mjerisht ai objekt ka pasë edhe ka bukur t'meta në realizim për arsye se ai është realizu menihere pas luftës, ndërsa sot ata që e shfrytëzojnë objektin me punën e tyne kanë kontribu në keqësimin e gjendjes dhe pamjes së objektit. Si shembull, ato terasat e kafiterive e tjera, janë improvizime t'cilat janë bo ma vonë, t'cilat na nuk i kemi pasë në projekt. Edhe shtimi i katit, i lartësisë së objektit është bo me insistimin e investitorit në atë kohë për arsye se objekti ka qenë më i ultë. Ni pjesë e objektit e cila është ka rruga kryesore është shtu ma vonë është bo ni aneks projekt për shtimin e... kështu që, në aspektin arkitektonik ka pasë disa ndryshime në raport me atë që është punu në konkurs. Po ato ndryshime natyrisht vetëm kanë ndiku negativisht në krejt konceptin t'cilin e kemi paramendu na kur e kemi punu si projektin ideor në konkursin e thirrur.

**Aurela Kadriu:** E qatëherë kur është thirr ai konkurs, çka ka qenë vizioni kur është thirr konkursi për projektimin e ni qendre tregtare, çka ka qenë vizioni i konkursit po edhe i juji që e keni projektin? Çka keni dashtë me bo përmes asaj qendre tregtare, m'i sjell qytetit përmes saj?

**Salih Spahiu:** Po çdo konkurs ka për qëllim që t'fihet ni zgjidhje sa ma e mirë funksionale arkitektonike, konstruktive e tjera, domethanë, edhe ky konkurs qëllimin kryesor e ka pasë ata. Ndërsa detyra projektuese ka rrjedh nga nevojat e rrjetës tregtare në atë kohë cila ka qenë në Prishtinë. Aty kryesisht e kanë ble Gërmia dhe Voçari, i kanë ble objektin. Fillimisht, kanë qenë të interesuar për me i vendos, domethanë, me i vendosë dyqanet e veta dhe me plasu mallin ata që t'cilët e kanë pasë në rrjetën tregtare t'tyne. E ma vonë, ma vonë mas luftës janë bo disa ndryshime, ju thashë edhe ma herët, janë bo disa ndryshime t'cilat kanë, e kanë keqësu, si me thanë, konceptin... e kane degradu konceptin fillestar të qendrës tregtare.

Qendra tregtare është e vendosun aty qysh e kanë parapa edhe urbanistat, domethanë, vendi i qendrës tregtare është m'u aty ku është parapa me planin urbanistik, me planin detal urbanistik të lagjes së Kodrës së Diellit. Natyrisht këto gabaritë e këto vulloneve janë rezultat i asaj që ma vonë na kemi punu si koncept, si koncept ideor, po edhe ma vonë si koncept kryesor, po gjithnji tu u mbështet në atë çka është kërkimi me planin detal urbanistik të lagjes Kodra e Diellit.

**Aurela Kadriu:** Mu m'duket shumë interesant ngjyrat edhe disa, gjithmonë kam mendu për disa vendime estetike në qat' ndërtesë. A m'tregon ma shumë për qit' pjesë? Procesin e mendimit para se me dizajnu-projektu?

**Salih Spahiu:** Siç e dini, kryesisht qendrat tregtare janë objekte bukur të mbylluna për arsye të destinimit që kanë edhe me u shfrytëzua hapësira sa ma, në mënyrë optimale. Na këtu kemi shku nga ideja që të dominon ma tepër edhe drita natyrale, siç e dini edhe e keni pa, janë shiritat ndriçues në pikëpamje, na që e quajm, në pikëpamje zenitale t'vëndosun ata i përshkojnë pjesët komunikative të objektit edhe japin ndriçim indirekt në lokale dhe pjesë tjera të objektit.

Ndërsa fasada është fasadë modulare, industriale, se zakonisht te këto objektet shkojnë me fasadë e varur, si me thanë, po këtu është... domethanë, dominon ajo pjesa e mbyllun e fasadës edhe me ni lojë të vullmeneve që është si rezultat i ni pllustike që kemi dashtë ta mbrijmë në tërë objektin. Për shkak se objekti është tëpër i gjatë dhe ka disa shmangie edhe në fasadë po edhe në vullmenet e veta, ka disa shmangie të cilat e bojnë, e hupin atë gjatësinë ne aspektin vizuel, gjatësinë e madhe te objektit. Objekti është i gjatë dikund 136 metra nëse nuk harroj.

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit është përfundu ndërtimi i...

**Salih Spahiu:** Projekti është përfundu diku n'vitet '87, '87 është fitu edhe konkursi pastaj e kemi punu projektin kryesor, ndërsa inagurimi i projektit është bo n'vitin 2001 pas luftës meniherë, n'vitin 2001.

**Aurela Kadriu:** A ka m'ri naj here me e pasë funksionin e vet përpara luftës bile minimalisht?

**Salih Spahiu:** Përpara luftës nuk ka qenë i përfundun objekti.

**Aurela Kadriu:** Edhe s'ka qenë i shfrytëzua a?

**Salih Spahiu:** S'ka qenë i shfrytëzua. Pas luftës është përfundu në vitin 2001, ndërmarrja banesore e Prishtinës e ka përfundu e pa pëlqimin tonë i ka bo disa ndryshime të cilat natyrisht kanë degradu

edhe konceptin fillestar. Mirëpo, këtu tek ne në Kosovë kërkush për atë nuk jep përgjegjësi. Domethanë, autori në Kosovë është ni njeri shumë, si me thanë, jo i çmum sa duhet.

**Aurela Kadriu:** E Kosovafilmi a ka pasë thirrje?

**Salih Spahiu:** Jo. Projektin e Kosovafilmit e kam fitu në bazë të referencave t'mia profesionale, domethanë, mu më është besu nga Azem Shkreli ish drejtor i Kosovafilmit, i ndjeri, dhe brenda në Ent më është dhanë ajo punë nga drejtori i Entit, i ndjeri, Vehbi Orana. Unë besoj se objektin e kam kry, projekti dhe objekti është kry në mënyrë të suksesshme për atë arsye edhe kam marrë disa shpërblime t'cilat i thashë ma herët. Domethanë, objekti ka qenë i porositun kështu, nuk ka qenë konkurs. Ka qenë projekt i porositun nga ana e investitorit, ndoshta perzgjedhja për mu ka qenë përcaktim i vet investitorit.

**Aurela Kadriu:** E çka ka qenë vizioni? Shumë po kom qef me ditë, se ma herët e përmendët, thatë që vendosja e ni objekti në hapësine t'caktume e përcakton jetën e plot njerëzve. Për qita po më intereson shumë me ditë, vizionin mbrapa vendosjes së qityne objekteve në qat' hapësirë, për shembull, vizionin e Kosovafilmit në qat' hapësirë po edhe çka ka synu me sjell Kosovafilmi duke ekzistuar qaty? Çka ka qenë vizioni i...

**Salih Spahiu:** Siç e dini, Kosovafilmi është objekt i vetmunë në atë hapësirë, ka qenë i vetmunë në atë... pikërisht ajo vetmia edhe konfiguracioni i terrenit kanë qenë elemente inspiruese që unë ta bëj ni koncept t'tillë. Ai objekt është bukur i gjatë i trajtun në bazë të funksioneve dhe teknologjisë specifike t'cilat i kanë këto objekte dhe aty kam shku që t'jetë, meqenëse ka qenë i vetmun, kom shku në vollovene të gjata dhe në ni gradacion që është kontaktibil me terrenin, me vet lokacionin e objektit. Edhe aty i kom... bile, bile s'pari aty i kam përdor të ashtuquajturat llantera ose shirita ndriçues e pastaj edhe në qendrën tregtare së bashku me, me kolegun që e përmenda, me kolegun Hamdi.

Vet objekti i Kosovafilmit ka qenë për mu ni, ni nxitje edhe ni sfidë e madhe se si ta konceptoj objektin për arsye se janë disa funksione tepër specifike, siç është salla tonike që është objekti në objekt për shkak të kushteve akustike ku bohet sinkronizimi i filmave, pastaj kanë qenë kinot, kjo depoja ku ruhen filmat, pastaj ka qenë pjesa administrative dhe pjesa shoqërore. Ato funksione i kam zbërthyr mnyrë që secila të ketë integritetin e vet në aspektin e... mirëpo, prapë lidhen njëra me tjetrën si tërësi organike.

Prej Kosovafilmit shifet qyteti i Prishtinës tepër bukur, dhe kam shku me ngjyrat e fasadës që janë ngjyra oker diku nëse ju kujtohet, ajo e Kodakut që prodhojke filmat e ka pasë ambalazhat asi... edhe e kam lidh pak, domethanë, çashtjen e përzgjedhjes së fasades e kam lidh pak me destinimin e objektit. Fasada është prej polestit të arminun, ni material i cili nuk është apliku në Kosovë, për herë t'parë është apliku këtu. Unë e kam pa atë material në Slloveni, në Ljubljana dhe meniherë kam ra në kontakt me prodhuesit e atij materiali. Këtë modulën dhe formën e fasadës ia kam dhanë une, ndërsa ata i kanë bo elementet tjera për ekzekutim të objektit.

I kanë bo si me thanë, elementet për m'i lshu në prodhim pastaj, elementet e fasadës. Krejt ajo fasadë është e ajrosun, është fasadë modulare e cila është vendosë në ni, në ni rrjet metalik paraparak të mureve të jashtme të objektit.

**Aurela Kadriu:** Kur e përmendët ngjyrën oker m'ra në mend edhe qendra tregtare atë pjesën me t'gjelbërt e gjelbërt, a e ka pasë edhe fillimisht, a ka qenë...

**Salih Spahiu:** Jo, nuk e ka pasë. Atë e ka bo investitori, kokë n'veti, pa u konsultu me neve.

**Aurela Kadriu:** Çfarë ngjyra keni...

**Salih Spahiu:** Atje kanë qenë ngjyra tjera, ngjyra ma t'omla, ngjyra t'dheut kanë dominu kryesisht me nuancë t'ndryshme ma t'çelne, ma t'mbylltë, po investitori...

**Aurela Kadriu:** Si kakao a?

**Salih Spahiu:** Po, si kakao si ashtu. Ndërsa investitori pa na pyet neve i ka pru ato pllaka edhe i ka vendosë në objekt. Sigurisht ka qenë çështja e çmimit apo naj arsye tjetër nuk e di. Me këtë deshta t'them që autorët në Kosovë janë të ballafaqun me problem të ndryshme, pikërisht për atë që nuk respektohen sa duhet autorësia.

**Aurela Kadriu:** Jo po m'doket interesant se tash kur e mendoj mrapa shumë e re edhe nuk e mbaj në mend qytetin qashtu, po kur e mendoj mrapa teksa flasim për Dardaninë, Bregun e Diellit, Ulpianën, këtu dominon nifarë ngjyre ose tulla ose beton, nifarë ngjyre shumë e ashpër e prapë qendra tregtare po thuni që ka qenë ngjyrë dheu kah e kafta e kjo Kosovafilmi ka qenë oker që janë relativisht ngjyra t'çelta...

**Salih Spahiu:** Unë harrova t'them për Kosovafilm, mbrapavija te Kosovafilmi është me pizha të gjelbërta edhe kjo ngjyrë në t'cilën jam përcaktu që ka qenë e lidhur ngusht me veprimtarinë e vet aty t'objektit ka qenë e tillë. Mirëpo, ka korespondu tepër mirë me mrpavijë të gjelbërt edhe objekti nga është pa nga shumë pika t'qytetit, domethanë, ajo ngjyrë ka ra n'sy nga shumë pika t'qytetit, domethanë, poenta ka qenë që edhe t'ipet ni ngjyrë që korespondon me veprimtarinë e objektit po edhe objekti të shihet nga disa pika të qytetit.

**Aurela Kadriu:** E qendrës tregtare pse patët vendos ngjyrë dheu m'i lonë?

**Salih Spahiu:** Po e kemi mendu si ngjyra ma të ngrohta, si ngjyra që janë ma... kjo është ni ngjyrë e ftohtë, tirkiz, ngjyra tirkiz, ni ngjyrë e ftohtë, mrpavijën e ka do objekte me tulla t'kuqe.

**Aurela Kadriu:** Mrena e ka ngjyrën e verdhë...

**Salih Spahiu:** Po mrenda e ka, mrenda e ka...

**Aurela Kadriu:** A ka qenë qajo ngjyrë që e keni paramendu ju?

**Salih Spahiu:** Mrenda po, mrenda po, mrenda po. Shumë gjana mrena janë respektu në aspektin e ngjyrave, ndërsa nuk është respektu në aspektin e funksionit.

**Aurela Kadriu:** A ka qenë e parapame qajo ngjyra që është mrena me qenë edhe jashtë?

**Salih Spahiu:** Jo, jo pak ma ndryshe ka qenë, ka pasë ngjyrë çokollate, ngjyrë kakao, nuanca për me tregu edhe plastikën e objektit edhe me hup atë që thashë, atë ndjenjën e gjatësisë së objektit.

**Aurela Kadriu:** Po kthehemi edhe një herë në Sarajevë se harrova, ma herët kur m'i tregut fotografitë m'kallxut që keni bo vizita nëpër Itali...

**Salih Spahiu:** Po. Si studentë të arkitekturës, si absolvent në kohën kur ishim absolventa kemi shku në Itali, kena vizitu disa objekte edhe disa qendra, disa qytete të njohura për nga historia e arkitekturës siç është Venediku, Firenca, Roma, Padua e tjera. Ai ka qenë ni ekskurzion i organizun nga ana e fakultetit edhe kemi kalu disa ditë me profesorë tonë në këtë udhëtim i cili ka zgjatë diku nja dhetë ditë, nja dhetë ditë. Natyrisht, në këtë kohë ata që ishin me ne, profesorët, na flisnin për zhvillimin e qyteteve në Itali dhe arkitekturës e cila ka qenë vërtetë në kohën e... n'kohën kur është ndërtu ka qenë ka dhanë ni vulë të kohës. Pastaj përveç Italisë kemi shku shpesh edhe në Bregdetin Adriatik ku i kemi pa hotelet nga landa e projektimit të hoteleve objekteve shoqërore dhe publike dhe... n'kohë të hotelerisë edhe kemi vizitu disa objekte në... sidomos në periferi të Dubrovnikut. Pra ishin disa ekskurzione me karakter profesional gjithmonë me ne vinte edhe profesori ose asistenti i landës përkatëse që të na flet për funksionet.

Me këtë është kompletu edhe ana praktike edhe ana teorike, kemi pa edhe në Pragë se si duket, ni hotel për shembull, me funksionet që i ka dhe si janë të determinune ato po edhe i kemi lidhë edhe me atë që kemi mësu gjatë studimeve.

## Pjesa e Tretë

**Aurela Kadriu:** Ju i keni kry studimet, fundi i '60-tave fillimi i '70-tave...

**Salih Spahiu:** Po, në vitin '73.

**Aurela Kadriu:** Viti '73, po. Po m'intereson çka ka qenë trend në arkitekturë n'qat' kohë? Se secila periudhë karakterizohet me nifarë trendi në arkitekturë. Çka ju ka pëlqy? Çfarë stili?

**Salih Spahiu:** Po shikoni, unë prej shumë gjana i kam mësu prej profesorëve t'mi të ndjerë. Natyrisht në atë kohë kanë qenë edhe disa prej kolosëve të arkitekturës bashkëkohore, t'cilët kanë dhanë vulë arkitekturës moderne siç është Le Corbusier, Alvar Aalto, Wright, Mies Van der Rohe, Kenzo Tange, Pier Luigi Nervi e tjerë. Këta kanë pasë ni stil të ashtuquajtur stil internacional. Disa prej tyne siç është Alto për shembull, se Wright është bazu në arkitekturën tradicionale dhe sidomos Wright njifet me arkitekturën organike t'vetën, i cili ka lanë shumë objekte të cilat janë në aspektin, si me thanë organik, objekte mjaft unikate.

Alvar Alto është finlandez, ai i ka lanë disa objekte t'cilat janë me traditë të Finlandës. Kenzo Tange është japonez i cili ka punu n'frymën e arkitekturës japoneze-tradicionale, po me premisa bashkëkohore. Le Corbusier ka punu krejtësisht në mënyrë moderne bashkëkohore. Oscar Niemeyer harrova me përmend është ni arkitekt i Brazilit i cili i ka projektu shumë objekte për qytetin e ri,



kryeqytetin e ri të Brazilit, Brazilia. Ai ka një arkitekturë mjaft të... bashkëkohore dhe është shumë i frymëzuar nga Le Corbusier, bile edhe kanë bashkëpunuar shumë herë së bashku me Le Corbusier.

Pier Luigi Nervi është inxhinier i ndërtimitarisë, po i ka bo disa pallate të sporteve tepër unike në Romë. Kështu që, në përgjithësi, në ndikim në të cilin... ndikimi që ka qenë tek unë ka rrjedh edhe prej këtyre profesorave të mi të ndjerë. Profesorët e mi gjithnjë na kanë fol që duhet gjanat t'i analizoni para se t'filloni me punë-projektu. Asaj premise gjithnjë iu kom përmbajtë, domethanë ni analizë e mirëfilltë duhet të bahet, analizë për lokacionin, analizë për klimën, analizë për kushtet tjera komunikacioni e tjera, para se t'fillon. Domethanë, nuk duhet menihere arkitekti me kap lapsin edhe me fillu me projekt, po duhet të analizojë mirë kontekstin ku gjindet ai objekt edhe për çfarë destinimi ka me shërby. E pastaj gjanat tjera rrjedhin ma lehtë edhe rezultati është ma i mirë edhe shumë herë edhe pozitiv ose tepër pozitiv.

**Aurela Kadriu:** A e mbani në mend... keni qenë i afërt me Bashkim Fehmiun, e mbani n'mend Grandin n'kohën kur është projektu edhe është ndërtu?

**Salih Spahiu:** Po. Profesor Bashkim Fehmiu është autor i zgjidhjes urbanistike të asaj pjese, po autor edhe i projektit. Në projektin ideor ai ka punuar së bashku edhe në projektin kryesor pastaj së bashku me ni arkitekt nga Beogradi që është qujt Dragan Kovaceviç. Grandi është projektu dikund viteve '70-ta, ai është i koncipun si ni objekt mjaft mirë i koncipun edhe i paraqit n'përfundimin e rrugës tash që quhet "Nëna Terezë" përfundimin e rrugës... domethanë, është në një vijë ndërtimore të objekteve tjera të rrugës "Nëna Terezë". Ai objekt për atë kohë ka qenë vërtetë objekt i ni niveli t'largtë, mirëpo tash s'fundit siç e dini... siç janë degradu shumë objekte tjera në Prishtinë, sidomos në Prishtinë është degradu edhe Grandi ni pjesë ku e kanë vendos ni fasadë, që unë e quaj fasadë industriale edhe duket si nifarë konzerve (qeshë).

Të tilla objekte që kanë ndryshu janë edhe Pallati i Shtypit, ish Pallati i Shtypit, ka ndryshu në mënyrë rrenjësose. Autori, kur ishte autori këtu thanë që nuk e ka njoftë... gati s'e ka njoftë objektin e vet.

**Aurela Kadriu:** Kur ka qenë?

**Salih Spahiu:** Ai është bo rishtaz është bo ky objekti i qeverisë, e kam fjalën për objektin ku është qeveria...

**Aurela Kadriu:** Po, po e kam fjalën kur ka qenë autori?

**Salih Spahiu:** Autori ka qenë para njo tri vjete nashta, dy apo tri vjet. Ai është Georgi Konstantinovski njëri prej arkitektëve ma t'njoftun të Maqedonisë i cili e ka kry ni pjesë të specializimit dhe të shkollimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai ka disa objekte unike edhe tepër t'mira në aspektin arkitektonik të kohës të ashtuqujtura arkitektura e frymës së brutalitetit menator beton i ka konviktet e studentëve në Shkup, pastaj e ka Muzeun e Arteve Bashkëkohore, ka edhe disa objekte tjera t'cilat vërtetë për atë kohë kanë qenë objekte të nivelit të lartë arkitektonik. Ai është njëri prej autorëve, është, të ish Pallatit të Shtypit. Kjo kulla e Pallatit të Shtypit ka qenë krejt ndryshe, nëse e mbani në mend.

**Aurela Kadriu:** Po, po.

**Salih Spahiu:** Ajo tash e ka ni fasadë industriale edhe është ndryshu pamja e objektit dhe profesori natyrisht që ka reagu. E njejtja gja ka ndodhë me ish hotelin “Bozhur”, pastaj me “EximKosin”, domethanë, janë bo disa herë, disa gjana t’cilat në aspektin arkitektonik e kanë bo ni pjesë në mjediset ku çmohet arkitektura edhe ku kontinuiteti urban-arkitektonik kishin me ndodhë.

**Aurela Kadriu:** Ju me siguri tash edhe me nifarë pikëpamje ma t’fokusume, meqenëse jeni arkitekt, e mbani në mend besoj qit’ far’ tranzicionin e qytetit... tranzicion goxha kaotik prej stilit oriental osman te stili modern edhe te ky që është sot, nuk e di çka m’i thanë, ky kaos. A kishit mujt ndoshta me na kallxu prej perspektivës t’juj, prej kujtimeve t’juja personale qysh ka ndodhë qiky tranzicion i qytetit?

**Salih Spahiu:** Nuk muj shumë t’lavdohem me situatën aktuale në Prishtinë dhe në Kosovë. Është bo ni laramani e ndërtimeve e sidomos ka ndërtime në urbanizëm se prej urbanizmit fillon edhe planifikimi hapësinor edhe prej urbanizmit fillojnë gjërat. Pastaj planifikimi arkitektonik është fazë e mëvonshme. Lagjet e reja, ju thashë edhe ma herët, lagjet e reja kanë pësu ni degradim të skajshëm urban, në aspektin urban. Nuk po flas për objekte të arkitekturës që është e qëndrueshme, që është e bukur, që është e mirë. Sot ka edhe materiale, sot është puna e arkitektëve është lehtësu mjaft për arsye se llojllojshmëria e materialeve t’jep mundësi edhe kreative shumë ma tepër, por me krahasu me periudhat e mahershme ka çrregullime, çrregullime evidente.

Ka çrregullime evidente negative natyrisht. Negative për kuptimin tim meqenëse shumë herë po thuhet edhe po thirren në norma edhe standarde evropiane t’cilat unë apriori i hudhi si të pabaza, se nëse kështu punon edhe vepron Evropa, vaj halli për ta. Domethanë, janë bo gjana t’cilat nuk i kanë respektu elementet themelore të urbanizmit siç është drita, dielli, qetësia e tjera, e tjera.

Sot shumë objekte janë tepër afër njëra tjetrës dhe nuk kanë diell sa duhet insolim, domethanë, sa duhet. Pastaj në shumë lagje të reja të qytetit nuk munden me kalu as automjetet e zjarrfikësave që është ni diçka e paimagjinueshme ose objektet janë të vendosura asisoji që nuk japin ni rregull dhe hapësirë. Domethanë, t’japin përshtypjen e ni suate, bash qysh e qytet edhe ju, ni suate kaotike. Sa i përket kohës së ma t’hershme që thatë, aty janë bo disa shkatërrime që nuk kanë guxu t’bohen, po ato janë bo në kohën kur është mendu që e reja ta zëvendëson të vjetrën. N’atë mënyrë ka ardhë edhe deri te ni çrregullim, si me thanë, çrregullim i ni kontinuiteti hapësinor edhe urbanistik.

**Aurela Kadriu:** (Se kuptoj min 10:08)

**Salih Spahiu:** Po. Trendi i shkatërrimit ka vazhdu n’atë kohë e sot po vazhdon në mënyrë tjetër. Sot po ndërtohet mjaft, mirëpo jo qashtu si duhet.

**Aurela Kadriu:** E çfarë pozite keni pasë në Ent deri në vitin 2011?

**Salih Spahiu:** Po ni kohë të gjatë kam qenë, kam punu, deri para luftës si projektus, kam udhëheq byronë projektuse, ni njësi ma t’vogël, domethanë, ni byro projektuse, se ashtu ka qenë e organizune puna në shumë byro projektuse. Ndërsa pas luftës kam qenë drejtor, por jo me dëshirë, por me insistimin e kolegëve edhe kolegeve aty të punësun që ta marr këtë detyrë. Meqenëse drejtorat tonë e lëshunë Entin, atëherë u detyrova që ta marrë. Jam mundu, meqenëse unë nuk kam pasë atë

profesion, që punën ta kryj me nderë. Jam mundu që sa ma shpejt pas luftës të startojmë me punë edhe ta marrim ni nivel profesional ashtu qysh duhet.

**Aurela Kadriu:** Qysh është përkthyer puna juje pas luftës prej para luftës? Domethanë, qato vitet e para p'ë di që në renovim edhe në rijetësim të ndërtesave po mandej çka ndodhë? Hajde flasim 2005-2011, qysh perkthehet puna juje? Çka boni?

**Salih Spahiu:** Po, mas luftës ju thashë që theksin kryesor e kam dhanë në riorganizimin dhe organizimin e punës në Ent, për arsye se Enti në të cilin kam punu ka pasë edhe pjesëtarë tjerë të kombësive tjera. Kështu që, në aspektin e projektimit, në aspektin e teknologjisë së projektimit ndodhën edhe disa ndryshime të cilat u deshtë të përmirësohen, t'korrigjohen, me kuadra për me mujt me... procesi i projektimit të shkojë ashtu siç duhet. Pra, në atë kohë u deshtë që të marrë edhe kuadro të reja, t'profileve të ndryshme në mënyrë që të kemi komplet zinxhirin e projektimit të rregullun ashtu siç duhet dhe në këtë mënyrë besoj që është arritë ni punë e mirë dhe është arritë që të mahet një kontinuitet të veprimtarisë themelore të Entit.

Në atë kohë kemi bashkëpunu dhe kemi punu për shumë organizata edhe jashtë Kosovës të cilët erdhen këtu me ndihma të ndryshme edhe humanitare edhe materiale dhe besoj që ato punë i kemi kry mirë dhe në nivel të duhur profesional.

**Aurela Kadriu:** Çka ndodhë me Kosovën, me Prishtinën menjherë mas luftës në aspektin urban?

**Salih Spahiu:** Po, Prishtina mas luftës në aspektin urban ka psu ni kaos t'madh urbanistik dhe arkitekturor. Kjo ma tepër rrjedh si mungesë e vetëdijes qytetare, pastaj edhe e ligjeve për arsye se aplikimi i ligjeve nuk e ka... domethanë nuk janë aplikuar edhe ato ligje t'cilat i kemi pasë në atë kohë. Kështu që, ka psu ndryshime të mëdha dhe janë bo ndërtime shumë, ndërtime që ne i qujam ndërtime informale, t'cilat ndërtime natyrisht lojnë pasoja të gjata dhe të paimagjinushme. Jo vetëm për gjeneratën tonë dhe gjeneratën pas nesh, por edhe për ardhmërinë e këtij qyteti.

Domethanë, janë bo dështimë të mëdha urbanistike të cilat tepër vështirë, ose me mjete shumë të mëdha materiale mund të iskanohen dhe korrigjohen. Ato janë si rezultat i mos vetëdijes nji dhe i lakmisë të madhe për me ardhë deri te profiti, deri te profiti shpesh herë edhe i pameritun. Këtu besoj që ka dështime të mëdha sidomos në aspektin e aplikimit të ligjit, na ligje kemi mjaft po aplikimi i tyre është tepër, tepër i dobët.

**Aurela Kadriu:** Çka ke vazhdu me bo pas pensionit?

**Salih Spahiu:** Pas pensionit kom vazhdu t'punoj prapë punën profesionale, natyrisht jo në, aty ku kom qenë por në studio tjetër, me një studio të quajtur "Studio 39". Aty kom punu me kolegun Mithat Hetemi, arkitekt, dhe me vajzën time Lindën, e cila është gjithashtu arkitekte, edhe me disa kolegë tjerë, të cilët kohë pas kohe janë angazhu për punë të caktume. Mirëpo kryesisht, na kemi qenë vazhdimisht aty, dhe kemi punu në projekte të ndryshme, projekte të ndryshme për, për klientë natyrisht të ndryshëm masi rrethanat edhe u ndryshuan.

Vlenë ndoshta të përmendet edhe objektet e "Lesnës" që i kemi ndërtu si kompleks, objekte të banimit dhe afariste. Pastaj qendrën tregtare të "Lesnës", klinika stomato-kirurgjike të doktor Ngadhim

Domit. Pastaj disa objekte të banimit individual në Prishtinë dhe në vende tjera të Kosovës. Pastaj këtë Shtëpinë e Miqësisë Norvegjeze-Kosovare në Restelicë, shtëpi malore.

Mandej për fshatin ndërkombëtar kemi punu objektin e administratës dhe objek... dhe administratës dhe një pjesë ka qenë objekt komercial. Mandej KOSTT-in e kemi punu rikonstruimin e objektit të KOSTT-it, rikonstruimin dhe rindërtimin e objektit të KOSTT-it dhe objekte të tjera t'cilat tash s'po i përmendi, por ka natyrisht. Tanë kohën kom punu si me thanë, si projektues, si arkitekt projektues.

**Aurela Kadriu:** Po vazhdojmë qaty pra...

**Salih Spahiu:** Në vitin 1978-79 kur ka startu fakulteti i arkitekturës, kom qenë i angazhuar nji kohë aty, në katedrën projektive si asistent dhe pastaj këtë angazhim e kom përsëritë edhe në vitin '86-'87 me... Kur ka startu arkitektura në Kosovë ka pasë tepër pak arkitekta, tepër, tepër pak. Domethënë ajo osht' si rezultat i nevojave që jonë parashtru atëhere për arkitektët në, në nivel të Kosovës. Këtu në fakultet kanë qenë të angazhuar edhe disa kolegë tjerë t'mij edhe jashtë orarit të punës kemi qenë të angazhuar për arsye se në atë kohë kom punu ne Entin për Urbanizëm dhe Projektme.

Po ashtu një përvojë, është një përvojë e mirë, unë kom qenë te një profesor nga Beogradi i cili ka mbajtur bazat e projektimit, landën bazat e projektimit. E pastaj, pastaj kom qenë edhe te një profesor nga Sarajeva, ma vonë në vitin '85... '86-'87, gjithashtu në katedrën e projektmeve.

**Aurela Kadriu:** A na tregon edhe tregimin e librit për Strausin?

**Salih Spahiu:** Po, po. Kur osht' botu libri i arkitektit akademik, arkitektit Ivan Strausit për zhvillimin e arkitekturës në vitin 1945-1990, ai më është drejtu me një letër dhe ka kërku që të, të i dërgoj fotot e objektit të Kosovafilmit. Dhe këtu në këtë libër domethanë që është botu në Svjetlost të Sarajevës, jemi prezentu me projektin e Kosovafilmit si autor nga Kosova. Të njejtën gjë më vonë e kanë bo edhe arkitektët Ilir Gjinolli, dhe Lulzim Kabashi me librin e vet, "Arkitektura Moderne, një abetare"... "Modernizmi në Kosovë", pardon, "Modernizmi në Kosovë, një abetare e arkitekturës".

Po ashtu edhe në këtë librin e kolegut Ilir jom i prezentuar me objektin e Kosovafilmit. Kjo ishte nji, domethanë nji, si me thanë nji respekt ndaj veprës sime, dhe besoj një prezentim adekuat i veprimtarisë time me objektin e, me një prej objekteve të cilat i kom projektu qysh ma herët. Duhet t'them se shumica prej projekteve të cilat i kom punu në karrierën time profesionale jonë realizu fatbardhësisht. Por ka edhe projekte të ndryshme që kanë mbetë pa u realizu siç ndodhë gjithmonë në jetën e përditëshme tonën.

**Aurela Kadriu:** A na tregon pak për pjesën si puntorë i shoqatës të arkitektëve edhe çka ka qenë fusha e veprimit të shoqatës?

**Salih Spahiu:** Në vitin 1999, në dhjetor saktësisht të vitit '99 jam zgjedhë kryetar i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, në kuvendin e parë pas luftës domethanë të arkitektëve. Unë së bashku me anëtarët e kryesisë kemi bo përpjekje që në atë kohë të reagojmë, shumë herë kemi reagu me shkrim për atë çka ndodhte në Kosovë, por mjerisht shumë gjana ngelen pa naj rezultat pozitiv. Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës dhe në përgjithësi arkitektët në shoqni kanë ni rol të rëndësishëm, shumë t'rëndësishëm. Domethanë, ata duhen të vlerësohen nga shoqërisa për kontributin e tyre, mirëpo për kontributin natyrisht pozitiv (qeshë)...

**Aurela Kadriu:** Deri në cilin vit keni qenë kryetar?

**Salih Spahiu:** Kryetar i shoqatës kom qenë deri në vitin 2003, domethanë një mandat të plotë. Në vitin 2003 është mbajtur kuvendi vjetor dhe pastaj është zgjedhë kryesia e re, dhe unë natyrisht i kom dorëzua detyrën kryesisë të re, të cilët kanë vazhdu punën ashtu qysh ata e kanë mendu që osht' ma s'miri. Kjo ishte sa i përket...

**Aurela Kadriu:** Diçka tjetër me shtu?

**Salih Spahiu:** Për profesor Bashkimin muj me shtu diçka. Për profesor Bashkimin kisha me thanë që ai tërë jetën ia ka kushtuar arkitekturës dhe urbanizmit. Domethënë, atë e ka pasë urbanizmin dhe arkitekturën mision jetësor dhe ai ka kontribut të madh si arkitekti i parë i Kosovës, ka kontribut të madh në themelimin e shumë institucioneve të randësishme për veprimtarinë e urbanizmit dhe arkitekturës në Kosovë. Profesor Bashkimi ka lanë vepra të cilat lirisht mund të quhen vepra monumentale sa i përket arkitekturës, sidomos në aspektin edhe teorik, por edhe praktik.

Ai ka qenë një pedagog shumë vjeçar i Universitetit të Prishtinës, me të cilin shumë gjenerata kanë, kanë, domethanë shumë gjenerata kanë qenë studentë të tij. Dhe ka dhanë një kontribut të çmushëm për arkitekturën dhe urbanizmin në Kosovë.

**Aurela Kadriu:** Cilat objekte i ka projektu përpos "Grandit"?

**Salih Spahiu:** Ai ka projektu edhe objekte t'cilat mjerisht nuk janë realizu. Ka projektu një palestër të sporteve më tre mijë vende, pastaj stadionin e qytetit të Prishtinës më njëzet mijë vende...

**Aurela Kadriu:** Qita që osht' a?

**Salih Spahiu:** Jo, një stadion tjetër. Po thom mjerisht nuk ka, nuk janë të relizume. Mirëpo, profesori ka qenë një njeri, thjeshtë një njeri i cili i ka frymëzë shumë arkitektë të ri, dhe ka qenë një njeri tepër vizionar. Ai ka parapa shumë gjana të cilat sot po ndodhin në Kosovë, mjerisht, dhe të cilat nuk kishin guxu të ndodhin, për arsye se lojnë gjurmë, gjurmë të pashlyeshme në Kosovë. Kosova është vend i vogël, dhe mundet çdokush me ndërta aty ku mendon, dhe aty ku ka profit ma t'mirë. Domethanë, ai

në atë aspekt ka qenë një luftar i pakompromis, sa i përket rregullit në hapësirë. Por shumë herë idetë e tij nuk janë përfillë, nuk janë përfillë dhe ato mund të them që mospërfillja e ideve të tij ka lanë pasoja bukur të mëdha në...

**Aurela Kadriu:** A ka qenë...

**Salih Spahiu:** Në, në hapësirë.

**Aurela Kadriu:** A ka qenë edhe kampusi ide e tij? Kampusi Universitar?

**Salih Spahiu:** Profesori ka punu shumë programe të randësishme, po, programe të randësishme të Prishtinës dhe të Kosovës. Nji prej projekteve kapitale të tij sigurisht osht' qendra e studentëve me objektet e fakulteteve. Ai e ka punu këtë projektin ideor urbanistiko-arkitektonik për qendrën e, e studentëve. Domethanë, me fakultete po flas. Por edhe kampusi ku janë konviktet, ai ka dhonë aspektin urbanistik sa e di une. Pastaj Ulpianën në aspektin urbanistik, e ka bo edhe programin për lagjën e Ulpianës. Ka punu programin për Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve, për Pallatin e Shtypit, dhe shume objekte tjera kapitale ose unikate me i kujtë për nevojat e qytetit të Prishtinës.

Ka qenë një ndër themeluesit e Entit Urbanistik të komunës të Prishtinës, pastaj ka qenë iniciator për themelimin e Entit për Urbanizëm dhe Projektme, këtu ku kom punu unë prej vitit '75, dhe institucioneve tjera. Domethanë, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e urbanizmit dhe arkitekturës, por edhe në aspektin pedagogjik.

Kur jemi te ndërtimet në Prishtinë ose në Kosovë në përgjithësi, une kisha me citu nji ndërtues të lashtë kinez, i shekullit XII, Kubllai Kan quhet, i cili thotë, "Për me ndërtu mirë, duhet të fillohet me ndërtimin e konceptit të mirë". Me këtë dua t'them se neve për shumë gjana na mungon pikërisht koncepti i mirë. Nuk është domethanë... edhe shumë gjana jemi tu i bo ad-hoc.

Na kur flasim për Prishtinën e re parasyshë kemi disa zona të qytetit në periferi të cilat janë proklamuar si qytet i ri, për shembull atje ku osht' Pallati i Drejtësisë sot, ajo pjesë osht' Prishtinë e re, quhet në prespektivë duhet të ndërtohet Prishtina e re atje. Me dalë më shiqu në teren, ju e keni, keni objekte të banimit individual që janë domethanë që janë të vendosuna ashtu qysh kush e ka pasë trollin ose mundësitë materiale. Domethanë, pushteti duhet t'i venë disa korniza ku mundet qytetari m'u sjellë ose nuk mundet m'u sjellë.

Përndyshe me hypë në objektin e Gorenjës shihet çka i kemi bo këtij qyteti, sa i përket periferisë po flas. Ndërsa këtu në qytet kemi objekte të larta ku mundemi me hypë edhe me pa se si duket Prishtina sot, që ka mujtë... se Prishtina osht' relativisht qytet i ri, relativisht qytet i ri dhe ka mujtë, ka mujtë të, të aplikohen rregullat dhe standardet, normat e duhura urbanistike, dhe jo vetëm të ndërtojmë, të ndërtojmë pa nji koncept t'mirë ashtu qysh ka thanë ky Kubllai Kan në shekullin XII.

Edhe diçka deshta t'them... ah, po, qyteti, qyteti osht' projekt që fillon një kohë, një herë edhe nuk përfundon, osht' qytet në vazhdimësi, osht' projekt në vazhdimësi. Domethanë, qyteti osht' projekt i cili vazhdon gjithnji. Edhe lypë kujdesje maksimale nga ata që, banorët aty, por edhe nga pushteti. Domethanë, osht' projekt i papërfunduar, por projekt i cili lypë gjithnji si me thanë, një mbikqyrje të mirëfillt dhe... të mirëfillt nga ata që e shfrytëzojnë domethanë hapsinën e qytetit. Kjo osht' tepër e randësishme për, për ma tutje për zhvillimin e qyteteve tona domethanë, jonë projekte të papërfunduara por që lypin një kontiunitet të mirë si në aspektin hapësinor, urbanistik, arkitektonik, e tjera, e tjera.

**Aurela Kadriu:** Shumë faleminderit!

**Salih Spahiu:** Ju lutem.